



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SHITES
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



13

Data/Datum/Date:	16.11.2023
Nr./Br./No	09/119
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës - Shtime
Nga/Od/From:	Komisioni për Hartimin e Draft Rregullores – Kryetare e Komisionit znj. Fatmire Ferati
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, drejtoresha - znj. Albana Fazliu
Lënda/Predmet/Subject :	Draft-Rregullore për procedurat dhe kriteret për zgjedhjen e laureatëve të vitit në sport

Duke u bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Shtimes Nr.02/785 dt. 13.09.2023, komisioni në përbërje: Fatmire Ferati, kryesuese e Grupit Punues, Idajet Rexhepi, Bajram Gashi, Lulzim Sahiti, Meriton Baftiu dhe Zenel Shabani, kanë hartuar Draft-Rregulloren për procedurat dhe kriteret për zgjedhjen e laureatëve të vitit në sport.

Si Komision i kemi mbajtur 3 mbledhje të rregullta dhe si rezultat e kemi nxjerrë draftin që e keni në materialin e juaj të punës. Jemi të bindur se Kuvendi do ta nxjerr në debat publik me qëllim që edhe qytetarët tjerë të kenë mundësi të japin kontributin e tyre.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-XXXX/23 datë:XX.XX.2023



Npi – 01/XXX datë: XX.XX.2023

DRAFT-RREGULLORE

**PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR ZGJEDHJEN E
LAURATËVE TË VITIT NË SPORT**

SHTIME, 2023

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neni 65 paragrafi 2 i Ligjit për Sport Nr.2003/24; Neni 14 i Ligji nr. 04/l-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport; Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimit të Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, pas procesit të diskutimit publik, në mbledhjen e mbajtur më XX.XX.2023, miratoi këtë:

DRAFT-RREGULLORE PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR ZGJEDHJEN E LAURATËVE TË VITIT NË SPORT

-I- DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra me të cilën Komuna e Shtimes jep lëvdata dhe shpërblime për punë të suksesshme dhe të vazhdueshme në sport, si dhe për kontribut të përhershëm për promovimin e sportit dhe imazhit të qytetit të Shtimes.

Neni 2

Shpërblimet dhe mirënjohjet u jepen punonjësve të sportit nga komuna e Shtimes, sportistëve, ekipeve sportive, si dhe personave tjerë juridik dhe fizik në përputhje me Ligjin për Sport dhe aktet tjera nënligjore të kësaj fushe.

Neni 3

Shpërblime dhe mirënjohje jepen për sportet e mëposhtme:

3.1 Futboll, Basketboll, Hendboll, Volejbol, Pingpong, Atletikë, Not, Boks, Xhudo, Mundje, Taekëondo, Autosport, Çilizëm, Tennis, Shejntari, Kick-Boks, Karate, Skitari, Karling, Kalërim, Lundrim, Bodybuilding dhe Fitnes, Peshëngritje, Shigjetari, Gjimnastikë, Pentatlon, Alpinizëm, Shah, Bouling, Aeronautikë, Minigolf dhe Peshkatari.

3.2 Shpërblimet do t’u jepen:

- Një (1) sportisti më të suksesshëm - meshkuj;
- Një (1) sportisti më të suksesshëm - femra;
- Një (1) sportisti më të suksesshëm i ri meshkuj;
- Një (1) sportisti më të suksesshëm e re femër;
- Një (1) skuadre më të suksesshme femrash;
- Një (1) skuadre më të suksesshme meshkujsh;
- Një (1) trajneri më të suksesshëm;
- Një (1) mirënjohje për afirmimin e sportit;
- Një (1) trajner më i suksesshëm për të ri;
- Një (1) punëtor sportiv më të suksesshëm;
- Një (1) sportisti më të suksesshëm / sportisti me aftësi të kufizuara;
- Një (1) klubi sportiv më të suksesshëm në sportet ekipore;

- Një (1) klubi sportiv më të suksesshëm në sportet individuale;
- Një (1) ekipi më të suksesshëm shkollor;
- Një (1) sportisti më të suksesshëm nga komuna e Shtimes që garon për një skuadër të huaj apo shtet të huaj. Shpërblimet do t'u jepen në formë të pllaketave, medaljeve dhe në formë të shpërblimeve tjera.

-II- KRITERET DHE PROPOZIMET

Neni 4

Të drejtën për të aplikuar si kandidat për shpërblime dhe mirënjohje kanë personat juridik dhe fizik, anëtar të komunitetit sportiv në komunën e Shtimes.

4.1 Kandidatët patjetër duhet të jenë anëtar të klubeve, të cilat janë të licencuara nga federatat kombëtare dhe të njohura zyrtarisht nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) dhe Departamenti për Sport në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

4.2. Njihet vetëm rang lista zyrtare në fund të vitit ose sezonit garues të Federatës Kombëtare ose Ndërkombëtare.

4.2.1 Në rast të ekzistimit të rangut identik pas zbatimit të kriterëve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, Komisioni ka të drejtën ekskluzive të marrë vendim që t'i jap përparësi individit dhe/ose ekipit. Në rast të një arritjeje të rëndësishme sportive, federata e sportit në të cilën kandidati ka arritur rezultatin nuk është në listën zyrtare të federatave kombëtare sportive dhe/ose është në proces të njohjes, Komisioni ka të drejtë të marrë një vendim me përjashtim të atij kandidati.

Neni 5

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport bënë shpalljen e konkursit publik në tabelën e publikimeve pranë Komunës së Shtimes dhe në ueb-faqen e Komunës. Afati për aplikim është 15 ditë kalendarike.

5.1 Në aplikimin të cilin e parashtrojnë kandidatët, duhet që të dorëzojnë biografi të shkurtër të karrierës sportive, vërtetim për pjesëmarrje dhe/ose rezultat, vërtetim për numrin e pjesëmarrësve në gara, rang listë dhe vërtetim nga federata kombëtare anëtarët të së cilës janë, në formë të shtypur ose në formë elektronike.

Neni 6

Komisioni për Shqyrtimin e Aplikacioneve

Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit i emëron kryetari i Komunës së Shtimes., me propozimin e organit kompetent, gjegjësisht Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS). Komisioni ka mandat prej 4 vjetësh, por mund të ndryshohet edhe për çdo vit sipas nevojës të cilën e propozon DKRS-ja.

Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve dhe ka këtë përbërje:

6.1. Dy (2) anëtarë janë nga DKRS, dy (2) anëtarë sportist eminent, të cilët nuk janë aktiv dhe anëtar në asnjë klub dhe një (1) pedagog (mësimdhënës) të edukimit fizik dhe sportit.

Neni 7

Detyrat e Komisionit

Komisioni mbledhet, i shqyrton aplikacionet dhe verifikon vërtetësinë e tyre duke u bazuar në rezultatet e arritura të secilit kandidat, harton një listë preliminare të fituesve të shpërblimeve sipas nenit 3 të kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Kryetari i komisionit, listën preliminare ia propozon për miratim drejtorit të DKRS-së dhe në afat prej 3 ditësh pune, kjo listë duhet të publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës

Neni 9

Procedura e ankesave

Ndaj vendimit për shpërblime dhe mirënjohje që jepen për sport, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 5 ditësh.

Vendimi i komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative

Neni 10

Komisioni i Ankesave

Kryetari i Komunës me vendim themelon komisionin për shqyrtimin e ankesave për përzgjedhje. Komisioni ka këtë përbërje:

- 10.1. Një anëtar përfaqësues nga DKRS-ja (Kryetar i Komisionit),
- 10.2. Një anëtar nga administrata komunale (anëtar i komisionit),
- 10.3. Një anëtar nga shoqëria civile (anëtar i komisionit).

Neni 11

Kryetari i Komunës, në bazë të buxhetit të planifikuar për sportist të vitit, merr vendim në lidhje me mënyrën dhe lartësinë e kompensimit të kandidatëve që do të shpërblehen.

Neni 12

Lista e kandidatëve të zgjedhur nga Komisioni është përfundimtare. Në rast të rezultatit të barabartë në lartësinë e pikëve të kandidatëve, vendimin përfundimtar, e merr Komisioni me shumicën e thjeshtë të votave.

Neni 13

DKRS e përcakton datën, vendin dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve. Nga Komuna do të shpërblehen vetëm 4 sportistë të nominuar:

- Sportisti më i suksesshëm;
- Sportiste më e suksesshme;
- Sportisti më i suksesshëm - i ri
- Sportiste më e suksesshme - e re, si dhe
- Trajneri dhe klubi më i suksesshëm, ndërsa shpërblimi është publik.

Neni 14

Rezultatet përfundimtare dhe votimi janë të disponueshme për publikun, individët (kandidatët), pasi të jenë shpallur më të mirët në sport në komunën e Shtimes.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Në rast të paqartësisë të dispozitave të kësaj rregulloreje interpretimin ligjor e bënë sektori administrativ i Komunës së Shtimes, përkatësisht Zyra Ligjore.

Neni 16

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse, dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Neni 17

Zbatimin e kësaj rregulloreje janë të obliguar ta bëjnë: Kryetari, të gjitha Drejtoritë Komunale si dhe të gjitha Institucionet në nivelin e lokal të komunës së Shtimes.

Neni 18

Rregullorja dhe Vendimi u dërgohen: Arkivit, Drejtorive, Institucioneve lokale, Kryetarit të Komunës, MAPL-së, MEF-it dhe Zyrës për Informim.

Kryesuesi i Kuvendit,
Adnan Ademi

v.v.

Tabela e Poentimit

Turnet zyrtare në Kosovë	Medalja e bronzët2 pikë Medalja e argjentë.....3 pikë Medalja e artë.....4 pikë
Kupa e Kosovës	Fitues i Kupës20 pikë
Kampionati i Kosovës	Medalja e bronzët10 pikë Medalja e argjentë.....20 pikë Medalja e artë..... 30 pikë
Turnet zyrtare Ballkanike	Medalja e bronzët5 pikë Medalja e argjentë.....10 pikë Medalja e artë.....15 pikë
Kampionatet Ballkanike	Medalja e bronzët.....15 pikë Medalja e argjentë.....30 pikë Medalja e artë.....45 pikë
Turnet zyrtare të Mesdheut	Medalja e bronzët10 pikë Medalja e argjentë.....20 pikë Medalja e artë.....30 pikë
Kampionati i Mesdheut	Medalja e bronzët..... 30 pikë Medalja e argjentë..... 50 pikë Medalja e artë..... 70 pikë
Turnet Evropiane	Medalja e bronzët25 pikë Medalja e argjentë..... 40 pikë Medalja e artë..... 60 pikë
Kampionatet Evropiane	Medalja e bronzët.....40 pikë Medalja e argjentë..... 80 pikë Medalja e artë.....100 pikë
Turnet Botërore	Medalja e bronzët35 pikë Medalja e argjentë.....55 pikë Medalja e artë.....90 pikë
Kampionatet Botërore	Medalja e bronzët70 pikë Medalja e argjentë.....140 pikë Medalja e artë.....220 pikë
Olimpiada	Medalja bronzët.....120 pikë Medalja e argjentë.....240 pikë Medalja artë.....500 pikë

Tabela për poentimin ekipor

Ekipi puna me grup-mosha Pioneer	10 pikë
Ekipi puna me grup-mosha Kadetë	10 pikë
Ekipi puna me grup-mosha Junior	10 pikë
Ekipi puna me grup-mosha Senior	10 pikë
Kampion i Kosovës me Pioneer	15 pikë
Kampion i Kosovës me Kadetë	20 pikë
Kampion i Kosovës me Junior	25 pikë
Kampion i Kosovës me Senior	30 pikë
Fitues i Kupës së Kosovës	20 pikë
Ekipi me shikueshmëri më të madhe	5 pikë
Ekipi me struktura të kompletuara	5 pikë

FORMA E NOMINIMIT PËR LAURATËT PËR SPORT

Emri i Klubit	
Emri dhe mbiemri i sportistit, sportistes, klubit, trajnerit, referit të nominuar	
Data e lindjes së kandidatit të nominuarit	
Gjinia	
Adresa e kandidatit të nominuar / klubit të nominuar	
Numri i telefonit, e-mail adresa e të nominuarit	
Lloji i çmimit për të cilin nominohet	
Data e themelimit të klubit	
Motivimi për nominim	
Emri i autoritetit që nënshkruan nominimin në emër të klubit	
Nënshkrimi	
Data dhe vendi	